

Sesioni i parë:

10:00-10:30

Regjistrimi i pjesëmarrësve

10:30-10:40

Fjala hyrëse:

Malinka Ristevska Jordanova, Drejtoreshë, EPI

10:40-12:10

Nga të pakët të mbetur të fundit: Dështim i kushtëzimit të BE-së në

Folësit:

- Florian Bieber, Qendra për Studime Jug-Lindore Europiane, Univerziteti i Graz-it
- Fatmir Besimi, Zëvendës Kryeministër për Çështje Europiane
- Deputet/VMRO-DPMNE (do të konfirmohet)
- Stevo Pendarovski, LSDM

Moderatore: Simonida Kacarska, EPI

12:10-12:45

Pauzë

Këndi i medimeve

Tryezi e rrumbullakët

BE-ja dhe kriza e tanishme politike në Maqedoni: levërdija, përfshirja, perspektivat



Data:

30 Mars 2015 (E Hënë)

Vendi:

Hotel Holiday Inn Shkup, Salla Milenium I

Sesioni i dytë

12:45-14:15

Opcionet për ndryshim dhe mundësia për përfshirjen e BE-së

Folësit:

Kristof Bender, Iniciativa Europiane për Stabilitet (ESI)

Nikola Dimitrov, Instituti i Hagës për drejtësi globale


H.E. Ernesto Massimino Bellelli, Ambasador i Republikës së Italisë në Republikën e Maqedonisë

Mersel Bilali, Profesor univerzitar

Moderator: Aleksandar Jovanoski, EPI

14:15-15:00

Koktel



THINKFUND
SUPPORTING POLICY RESEARCH

Qëllimi

Qëllimi i tryezës së rrumbullakët është që të inkurajojë një debat të hapur dhe konstruktiv në mes të aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror, BE-së dhe aktorëve kombëtarë mbi opsionet për zgjidhjen e krizës aktuale politike në Maqedoni.

Debati do të fokusohet kryesisht në bashkëveprimimin e aktorëve vendas dhe të BE-së në krizën aktuale politike në Maqedoni dhe modalitetet e mundshme si dhe opsionet e levërdishme të BE-së në këtë situatë të veçantë.

Praparija

Në fund të viteve '90, me shmangjen e konflikteve pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Maqedonia ishte favoriti i procesit të Stabilizim-Asociimit. Shperthimi i konfliktit etnik në vitin 2001 përfundoi me Marrëveshjen e ndërmjetësuar ndërkombëtarisht së Ohrit, e cila rezultoi në ripërcaktimin me kushtetutë të ndarjes e pushtetit mes shumicës maqedonase dhe të komunitetit jo-shumicë shqiptar dhe përmirësimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë. Pajtimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit dhe reforma zbatuar demokratike, e inkurajuar kryesisht nga perspektivat e integritit në BE, mundësuan ndarjen e statusit të kandidatit për anëtarësim në BE në vitin 2005. Në vitin 2008, hyrja e Maqedonisë në NATO ishte e bllokuar nga Greqia, për shkak të mosmarrëveshjes së emrit . Për të njëjtën arsye të gjashtë rekomandimet nga Komisioni Evropian në periudhën 2009-2014 nuk kanë rezultuar me vendim të Këshillit për të nisur negociatat e pranimit. Përpjekjet për të zgjidhur çështjen e emrit mbeten të pafrytshme.

Në ndërkohë, është vënë re një devijim i ashpër në standardet demokratike, që gradualisht ka evoluar në krizën aktuale politike. Raporti i fundit i KE-së ishte më kritik se ndonjëherë me pare, duke treguar për *"kulturën gjithnjë përçarëse politike, shqetësime serioze në lidhje me rritjen e politizimit dhe kontrollit të qeverisë mbi institucionet shtetërore dhe mediave, si dhe një situatë ndëretnike ende të brishtë"*.

Kriza politike ka evoluar edhe më tej. Qeveria, e kryesuar nga VMRO -DPMNE, që ka qenë në pushtet për 9 vjet, në janar 2015 paraqiti kallëzim penal kundër katër personave duke përfshirë edhe kreun e opozitës, duke deklaruar se ai u përpoq të kryej krimin "dhunë ndaj përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore më të lartë "në një proces të quajtur" Grushteti ". Procesi "Grushteti" është i bazuar në akuzat për spiunazh të bëra për një "shërbim të huaj". Më 9 shkurt 2015 opozita- LSDM ka zbuluar se Agjencia e Inteligjencës Shtetërore ka përgjuar në mënyrë të paligjshme mbi 20,000 qytetarë dhe filloi të transmetojë publikisht bisedat e përgjuara, kryesisht ato të ministrave. LSDM ka ngritur akuza kundër Kryeministrit, Ministrave dhe shefit të Sigurisë Kombëtare dhe Agjencisë Kundër-Inteligjencës. Regjistrimet e gazetarëve të përgjuar dhe diplomatëve u janë dorëzuar direkt atyre.

Pas vizitës së tij në Maqedoni, në shkurt 2015, duke eksploruar mundësitë për ndërmjetësim të BE-së, komesari Hahn deklaroi se Maqedonia ishte në "krizë të thellë politike" pas së cilës presidenti i Komisionit Junker ka anuluar takimin e tij me kryeministrin Gruevski.

Në reagimet e tyre, institucionet e BE-së dhe disa vendeve anëtare të BE kanë shprehur kryesisht "shqetësim të thellë" mbi situatën, duke i bërë thirrje institucioneve për të zgjidhur rastet në një "mënyrë të drejtë dhe transparente".